



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 61 parag. 1.8, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2019, merr,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Me këtë vendim vëhen në diskutim publik:

- *Propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës*
- *Propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës*

Neni 2

1. Diskutimi publik për propozim Rregullore për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej **03.06.2019 deri më 03.07. 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **17.06.2019, në orën 10;00**, në objektin e Komunës, salla e Kuvendit, dhe zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim dhe koordinim me Grupin Punues për hartimin e propozimit në fjalë, dhe shërbimet tjera përkatëse.
2. Diskutimi publik për propozim Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës zgjat 30 ditë përkatësisht prej **03.06.2019 deri më 03.07. 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më **18.06.2019 në orën 10;00**, në objektin e Komunës, salla e Kuvendit, dhe zbatohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjen dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Grupin Punues për hartimin e propozimit në fjalë, dhe shërbimet tjera përkatëse.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat: nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net të cilat pastaj i përcjellin në Drejtorinë përkatëse dhe tek Grupi punues për hartimin e Propozim Rregulloreve në fjalë.

Neni 4

Dokumentet e Propozim Rregulloreve sipas nenit 1, publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës
<http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Neni 5

Diskutimet publik e zbatohen nga Drejtoritë e cekura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 1 të këtij Vendimi në bashkëpunim me Grupin punues të ngritur nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.02-020/04-0033331/19 të datës 18 prill 2019, dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që obligohen të përgatitin raportin nga diskutimi publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-070/05-0043565/19
Podujevë, 31 maj 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

RREGULLORE KOMUNALE Nr. __/2019

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

DRAFT

Maj 2019

Podujevë

Në bazë të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 50/2009, nenit 17 pika e) neni 40.2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 15 pika c, të Statutit të Komunës së Podujevës . 01-1/298-10, të datës 12.10.2009. Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më __ 2019 aprovon këtë:

R R E G U L L O R E

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore krijohet baza juridike për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal për qytetarët e komunës së Podujevës (më poshtë e quajtur: Komuna), në mënyrë që të jetë e përballueshme dhe në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës.

Në procesin e mbrojtjes dhe përparimin e mjedisit është e domosdoshme njohja dhe zbatimi i legjislacionit mjedisor, si parakusht për shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, për mbrojtjen efikase të sistemeve të gjalla dhe përparimin e tyre.

Vlerat natyrore gjeomorfologjike, hidrologjike, fitogjeografike, ambientale, peizazhore dhe estetike e hapësirës gjeografike të Podujevës, si dhe vlerat specifike të tyre, kanë një rëndësi të veçantë në aspektin shkencor, edukativ, kulturor, ekonomik dhe meritojnë tretman dhe status të

veçantë shoqëror, sepse mjedisi duhet të ruhet jo vetëm për brezat e tashëm, por edhe për brezat e ardhshëm.

Duke parë nevojën e arritjes së standardit për mjedisin në Podujevë në harmoni me ato të Bashkimit Evropian, dedikuar qëllimit që mundëson një mjedis të shëndetshëm në rritje për qytetarët e Podujevës, duke pasur parasysh së vënia e standardeve të tilla dhe krijimi i një mjedisi të tillë duhet të formohet një standard, në mënyrë që të jetë konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Në këtë rregullore janë dhënë kushtet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në nivelin lokal, duke pasur parasysh gjithmonë edhe mbrojtjen e mjedisit regional dhe më gjerë, pasi që dihet se ndotja nuk njeh kufi.

II. Qëllimi i rregullores mjedisore

Neni: 2

Në këtë rregullore janë përcaktuar rrethanat dhe kushtet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në komunën e Podujevës në përputhshmëri me specifikat e saj:

1. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj rregulloreje është krijimi i një baze me rregulla mjedisore, e cila do të promovojë një ngritje të mjedisit të shëndetshëm për popullatën e Podujevës duke synuar arritjen e standardeve mjedisore Evropiane.

Qëllime specifike të rregullores janë:

2. të sigurojë një mjedis që është i përballueshëm dhe konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës së Podujevës.

3. të definojë punën e autoriteve publike në komunën e Podujevës që do të bëjnë implementimin e rregullores, në bazë të autorizimeve dhe detyrave të dala nga dispozitat e Ligjit për Mbrojtje të Mjedisit dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

4. të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e personave dhe ndërmarrjeve të ndryshme të cilat veprojnë në komunën e Podujevës.

4. te përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen e Mjedisit duke përfshirë detyrimin dhe përdorimin me përgjegjësi të resurseve natyrore, me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndetshëm.

III. Objektivat e rregullores mjedisore

Neni: 3

Objektivat themelore të rregullores janë:

- Zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe minimizimi, ose ndalimi i atyre aspekteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera që përbëjnë një rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.
- Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës prodhuese, si dhe mbrojtja e akumulimeve gjenetike të natyrës.
- Zbatimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit në hapësirën e komunës së Podujevës.

IV. Përkufizimet terminologjike

Neni: 4

Biodiversiteti= Shumëllojshmëri Biologjike: Kompleksiteti biologjik i një numër specimesh të organizmave të një ekosistemi. Term që shënon të gjitha aspektet e shumëllojshmërisë biologjike, por sidomos pasurinë e llojeve, kompleksitetin e ekosistemeve dhe variacionin gjenetik.

Burim natyrore me vlerë: do të thotë, fenomen i njohur natyror që është shumë i vlefshëm, i paktë dhe unik, një burim i tillë natyror mund të përfshijë fenomen unik gjeografik siç janë fosilet, mineralet të pa-zakonshme, akumulime apo formacione, shpella, gërxhe, lumenjve, fusha me ujë, bimë dhe kafshë unike, si dhe ekosisteme dhe peizazheve.

Degradim mjedisor: do të thotë degradim substancial i mjedisit (në atë shkallë që ndikon në kualitetin e jetës), nga ndotja, mbeturinat dhe plehrat ose nga përdorimi apo shfrytëzimi i paautorizuar i burimeve natyrore.

Dëm i mjedisit: është aktiviteti që ka potencial të jashtëzakonshëm dhe të dukshëm që ta dëmtojë mjedisin në mënyrë substanciale, apo të shkaktoj aksident mjedisor.

Ekologji: Shkenca biologjike e cila merret me studimin e ndërlidhjeve të ndërlikuara dhe marrëdhënieve midis faktorëve abiotikë (mjedisorë) dhe biotikë (organizmave të gjallë), organizmave ose grupi të organizmave me njëri tjetrin dhe midis organizmave e mjedisit të tyre jetësor. Studim i marrëdhënieve midis organizmave dhe midis organizmave e mjedisit të tyre jo të gjallë.

Ekosistem: Një njësi e cila përbëhet prej ndërveprimit të organizmave dhe mjedisit ku jetojnë. Bashkësi organizmesh të ndërvarur, së bashku me mjedisin ku jetojnë e me të cilin ata ndërveprojnë e që është i dallueshëm nga bashkësitë e mjedisi pranë tyre.

Fitocenoza = Nënkupton shoqërimet, mbulesën e individëve të llojeve të ndryshme bimore në një ekosistem.

Fitodiversiteti = Kompleksiteti biologjik i një numër specimesh të organizmave bimore të një ekosistemi. Term që shënon të gjitha aspektet e shumëllojshmërisë bimore, por sidomos pasurinë e llojeve, kompleksitetin e ekosistemeve dhe variacionin gjenetik.

Hedhurinë - pjesë e mbeturinës, lëndë ose substancë e cila mbetet pas përpunimit të mbeturinës, komponente ose elemente të cilat nuk kanë vlerë përdorimi.

Inspektor mjedisor: do të thotë personi që ka autorizimet e duhura me ligj apo aktet normative të nxjerra nga ligji për mbrojtje të mjedisit, të bëjë inspektimin e zhvillimeve dhe aktiviteteve të

tjera si dhe determinimet preliminare rreth konformitetit apo jo- konformitetit të aktiviteteve të tilla me këtë rregullore apo akte normative të nxjerra në pajtim me ligjin.

Komuna – njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Leje Mjedisore Komunale (LMK) - është dokument me shkrim që e lëshon Komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas Ligjit dhe Akteve tjera nënligjore;

Mbeturina të rrezikshme: janë mbeturina të cilat janë të ndezshme, korrozive, reaktive ose toksike dhe mbeturina të tilla janë klasifikuar si të rrezikshme nga BE-ja.

Ndotës: do të thotë personat që shkaktojnë ndotje.

Mbeturina: çdo substancë ose lëndë të cilën zotëruesi e hedh, mendon ta hedh ose është i detyruar ta hedh.

Mbeturinat komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbrojtja e mjedisit: Çdo aktivitet që synon ruajtjen ose përmirësimin e pastërtisë së mjedisit përmes parandalimit të shkarkimeve të substancave ndotëse apo zhurmave në mjedis. Gjithashtu këtu përfshihen aktivitete që synojnë konservimin e specieve të egra dhe habitateve të tyre, mbrojtjen e peizazhit, aktivitetet për monitorimin dhe analizimin e kushteve mjedisore.

Mjedis = Ambient: Tërësia e të gjitha kushteve të jashtme që ndikojnë jetën, zhvillimin dhe mbijetesën e një organizmi. Tërësia e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, zhvillohet një dukuri etj; gjithçka që rrethon një organizëm dhe ndikon mbi të; hapësira a sendet që na rrethojnë.

Ndotës: do të thotë personat që shkaktojnë ndotje

Ndotje: do të thotë shkarkimin e një substance (duke përfshirë substanca në formë të ngurtë, lëngët apo në formë të gaztë) ose energji (duke përfshirë vibrimin, radiacionin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma të tjera të energjisë) në mjedis, që ka potencial domethënës që t'i shkaktojë dëme shëndetit njerëzor, organizmave të gjallë apo ekosistemeve apo dëm mjedisor.

Person: do të thotë një person fizik apo juridik.

Pëlqim mjedisor: do të thotë autorizim me shkrim i nxjerrë në pajtim me këtë ligj, që në rrethana të përshkruara me këtë ligj ose akte normative të nxjerra në pajtim me këtë ligj, më qëllim marrjen e lejes për ndërtim.

Plan Rregullues Urban i Hollësishëm: Nënkupton planin e përcaktuar sipas Ligjit për Planifikim.

Plan Zhvillimor Komunal PZHK: Nënkupton planin e përcaktuar sipas Ligjit për Planifikim.

Plan Zhvillimor Urban PZHU: Nënkupton planin e përcaktuar sipas Ligjit për Planifikim.

Publiku: konsiderohet një ose më shumë persona juridik ose fizik , shoqatat e tyre organizatat apo grupimet.

Resurset natyrore: janë të gjithë përbërësit e natyrës që njeriu i shfrytëzon për qëllime ekonomike. Resurset natyrore mund të jenë : të papë (lëndët minerale) dhe të përsëritshme (të mirat biologjike, uji, toka e përsëritshme)

Riciklim: do të thotë mbledhja selektive e mbeturinave komunale me qëllim të riprodhimit dhe ripërdorimit. Materiali i njëjtë përdoret për të prodhuar një produkt të njëjtë ose të ngjashëm me të përparshmen.

Sanimi: është proces i ndërmarrjes së masave për ndalimin e ndotjes dhe degradimin e mëtutjeshëm të mjedisit deri në nivelin i cili është i sigurt për shfrytëzim të mëtutjeshëm të lokacionit, duke përfshirë, rregullimin e hapësirës, revitalizimin dhe rikultivimin.

Sipërfaqe publike: konsiderohen rrugët, trotualet, parkingjet, rrugicat, stacioni i autobusëve, parqet, pompat e derivateve, tregjet, varrezat, shëtitorët, terrenet sportive dhe argëtuese, pishinat publike, hapësirat ndërmjet dhe rreth ndërtesave kolektive të banimit, toka të pa shfrytëzuara.

Statusi i mjedisit të rrezikuar: është gjendje mjedisore kur tejkalohet shkalla e ndotjes e përcaktuar në bazë të matjeve , hulumtimeve dhe vlerësimit të indikatorve të gjendjes , në raport me normal e lejuara.

Vlerat e natyrës: janë pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose interesit shkencor, estetik, kulturor, historik, arsimor dhe ekonomik.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (“VNM”) do të thotë vlerësimi për të determinuar dëmet e mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitete të tjera zhvillimore.

Zona të mbrojtura natyrore: Zona me pasuri ose llojshmëri të rrallë natyrore të cilat vihen nën mbrojtje për të siguruar ruajtje të qëndrueshme dhe për të penguar ndonjë përçarje. Janë pjesë të ruajtura të natyrës, me veçori dhe vlera të veçanta natyrore, të cilat kanë rëndësi të përhershme ekologjike, shkencore, kulturore-arsimore, rekreative dhe turistike dhe si vlera me interes të përgjithshëm gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Zonat e mbrojtura të natyrës: Zona me pasuri ose llojshmëri të rrallë natyrore të cilat vihen nën mbrojtje për të siguruar ruajtje të qëndrueshme dhe për të penguar ndonjë përçarje. Në këto zona nuk lejohet zhvillimi i asnjë aktiviteti ekonomik, dëmtim ose ndryshim.

Zonë Urbane: zona e cila fizikisht formon pjesën e një qyteti dhe karakterizohet me pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, densitetit të lartë të popullsisë dhe banimit, punësim dhe transport të konsiderueshëm dhe infrastrukturë tjetër. Zonat urbane mund gjithashtu të përmbajnë zona të gjelbra zakonisht të shfrytëzuara për qëllime rekreative.

Zoodiversiteti: Kompleksiteti biologjik i një numër specimesh të organizmave shtazorë të një ekosistemi. Term që shënon të gjitha aspektet e shumëllojshmërisë shtazore, por sidomos pasurinë e llojeve, kompleksitetin e ekosistemeve dhe variacionin gjenetik.

V. Mirëmbajtja e sipërfaqeve publike dhe hapësirave të tjera

Neni: 5

Për mirëmbajtjen e parkingjeve, tregjeve, sipërfaqeve të gjelbëruara, varrezave, shtratin e lumenjve, shtratin e proçkave, kujdesen ndërmarrjet e autorizuar.

Neni: 6

Të gjitha oborret duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër, ku për mirëmbajtje të tyre obligohen nga kjo rregullore që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e tyre (Këshillat banesorë apo të lagjeve).

Neni: 7

Me qëllim të mirëmbajtjes më të mirë të gjendjes së pastërtisë në vendet publike vendosen shportat e mbeturinave, për të cilat kujdeset ndërmarrja përkatëse, nëse është e specifikuar me kontratë.

Neni: 8

Për mirëmbajtjen e pastërtisë në tregje dhe objektet e tregjeve do të kujdeset ndërmarrja e obliguar për menaxhimin e tyre dhe ato duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë tregjet, pas kalimit të kohës së punës, duhet të pastrohen .

Neni: 9

1. Për pastërtinë në oborret e Shkollave të Komunës së Podujevës janë të obliguar të kujdesen dhe ta menaxhojnë vetë shkollat.
2. Shkollat janë të obliguara që të kujdesen për gjelbërimin dhe ruajtjen e tij në oborret shkollore.

Neni: 10

Institucionet administrative dhe publike janë të obliguara t'i mirëmbajnë oborret e tyre.

VI. Mirëmbajtja e pastërtisë dhe ruajtja nga degradimi mjedisor

Neni: 11

Obligohet çdo ekonomi familjare dhe objekte afariste që të kyçet në sistem të kanalizimit të ujërave të zeza, në ato vendbanime ku ekziston sistemi i kanalizimit publik.

Neni: 12

12.1. Të gjithë qytetarët, pronarët e ndërtesave familjare të banimit, pronarët e lokaleve afariste në vendet urbane dhe jo urbane kanë për obligim të mirëmbajnë hapësirat rreth objekteve të tyre rrugët publike dhe objektet e ujit si dhe sipërfaqe të tjera të hapura me interes të përgjithshëm.

12.2. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, pa përjashtim të asnjë qytetari, kanë për obligim të ruajnë ambientin nga degradimet e ndryshme si: brenda zonave urbane ndalohej marrja e dheut si dhe prishja e argjinaturave rreth lumenjve dhe rrjedhave të tyre si dhe vendeve të ndryshme, marrja e rërës dhe gurëve në lum. Nxjerrja dhe eksploatimi i shkëmbinjve të cilët bëjnë degradim mjedisor. Të gjitha këto kategori të ndotjes dhe degradimit, janë të obliguar që të pajisen me leje përkatëse.

12.3 Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit në Komunën e Podujevës ndalohej:

- a) Hedhja e mbeturinave dhe materialeve tjera fundrrinore në shtratin e lumenjve, përrenjve, kanaleve, në rrugë dhe sipërfaqeve të tjera publike;
- b) Hedhja dhe vendosja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve si dhe në pronën e tyre, në vendet ku distanca nuk është e mjaftueshme nga vendet e banuara me popullatë njerëzore;
- c) Përdorimi i puseve të braktisura për t'i derdhur ujërat e zeza apo për t'i deponuar mbeturinat;
- d) Larja e veturave dhe automjeteve bartëse në lumenj dhe rreth brigjeve të tyre;

- e) Ndezja e zjarreve prej mbeturinave dhe materialeve të tjera që ndotin ajrin dhe mjedisin në përgjithësi;
- f) Ndezja e zjarreve prej gomave dhe materialeve prej gomës dhe tekstilit.
- g) Dëmtimi i bimëve (luleve) dhe pjesëve të gjelbëruara të qytetit në përgjithësi
- h) Vendosja e ushqimit të kafshe në vende dhe hapësira publike ku e dëmtojnë hapësirat e gjelbëruara dhe imazhin e tyre në përgjithësi.
- i) Ndalohet eksploatimi i dheut në hapësira publike.
- j) Kompanitë janë të obliguara, që pas kryerjes së punimeve, t'i largojnë mbeturinat nga vend punishtja dhe deponimi i tyre të bëhet në deponi të licencuar.

12.4 Me qëllim të ruajtjes së sipërfaqeve të gjelbëruara publike ndalohet:

- a) Krasitja, prerja e drunjve, thyerja e degëve të fidanëve, kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbëruara pa pëlqimin e Drejtorisë, respektivisht shërbimit përkatës.
- b) Shfrytëzimi për kullosa të kafshëve.
- c) Largimi, djegia, dëmtimi i shenjave të mbishkrimit të vendosura me qëllim të ruajtjes së mjedisit dhe sipërfaqeve të gjelbëruara.

VII. Mbrojtja e Biodiversiteti

Neni: 13

13.1 Me qëllim të mbrojtjes së Zoodiversitetit në komunën tonë ndalohet gjuetia e pakontrolluar dhe e palicensuar.

13.2 Ndalohet rreptësisht gjuetia në zonat e mbrojtura dhe rezervatet e shtazëve të parapara nga shoqata e gjuetarëve për mbrojtje të shtazëve.

13.3 Ndalohet gjuetia e zogjve mishngrënës (Fajkoi, Shqiponjen e maleve, Huti malor) si dhe atyre jo mishngrënës (thëllënza e gurëve, pulëdushku).

13.4 Ndalohet gjuetia e shtazëve të mëdha (ariu i murrëm, kaprollit, ujkut, dhelprës dhe macja e egër).

13.5 Ndalohet shkatërrimi dhe dëmtimi i foleve të zogjve, shpellave dhe çerdheve të shtazëve tjera, prerja e drunjve ku janë të vendosura folet e zogjve.

Neni: 14

Me qëllim të mbrojtjes së fitodiversitetit ndalohen këto veprimtari në zonat e ndryshme Fitosociologjike dhe fitocenologjike në territorin e komunës.

14.1 Shkatërrimi dhe dëmtimi i monumente natyrore botanike, monumente natyrore hidrologjike dhe monumente natyrore gjeomorfologjike të shpallura si të mbrojtura me PLVM dhe PZHK.

14.2 Prerja dhe dëmtimi i zonave dhe peizazheve të mbrojtura bimore të shpallura si të mbrojtura me PLVM dhe PZHK.

VIII. Shfrytëzuesit e resurseve natyrore

Neni: 15

15.1 Personat juridikë ose fizikë mund të kryejnë aktivitete në hulumtimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

- a) Paraprakisht duhet të paraqes kërkesë në institucionet përkatëse, dhe të merr leje përkatëse;
- b) t'i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis(VNM), në përputhje me nenin 22 të Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- c) të respektojë dispozitat ligjore dhe rregullat lidhur me aktivitetet e tij, nëse burimi natyrore është pronë publike, të ketë koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër adekuate për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve në përputhje me ligjin;
- d) gjatë aktivitetit të zvogëlojë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij dhe
- e) pas ndërprerjes së veprimtarisë, të rehabilitojë ose rikthejë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit.

IX. Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) dhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Leje Mjedisore Komunale (LMK)

Neni: 16

16.1. Zbatimi i punëve ndërtimore apo instalimeve dhe skemave të ndryshimit-intervenime në mjedise natyrore, duke përfshirë ekstraktimin e mineraleve, e në qoftë se një projekt i tillë ka potencial të bëjë dëm mjedisor, është i obliguar të bëjë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

16.2. Personi, ndërmarrja apo organi publik që planifikon të modifikojë një projekt dhe, në rast se kjo paraqet një rrezik potencial për të rritur apo zmadhuar shkarkimin ose shpërndarjen e dëmit mjedisor, duhet t'i nënshtrohet VNM-së apo Raportit për LMK.

16.3. Komuna nuk do të lëshojë Lejen për Ndërtim apo kryerje të aktiviteteve, nëse një projekt i tillë është subjekt i VNM-së apo LMK-së dhe për të cilin nuk është siguruar pëlqim mjedisor, respektivisht leja mjedisore apo LMK nga autoritetet kompetent (MMPH apo Komuna).

Neni: 17

Vlerësimi i ndikimit në mjedis, por edhe Raportit për LMK do të bëhet në përputhje me aktin e veçantë të cilin e nxjerr Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Neni: 18

Askush nuk ka të drejtë të ndërmarrë, apo kryej ndonjë veprimtari, e cila mund të paraqes ndikime në mjedis dhe për të cilin më parë nuk është siguruar autorizimi mjedisor nga MMPH apo Komuna, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera nënligjore.

Neni: 19

Obligohen që çdo veprimtari apo objekte të pajisen me Leje Mjedisore Komunale (LMK) të cilat janë të precizuara me Udhëzim Administrativ për Leje Mjedisore Komunale.

X. Gjelbërimi i hapësirave publike

Neni: 20

Me qëllim të zgjerimit dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve publike, të gjelbëruara dhe mbëltimit të fidanëve në qytet dhe vende urbane, duhet të mbikëqyren dhe mbrohen në mënyrë të caktuar me këtë rregullore:

- a) Sipërfaqet e gjelbëruara (parqet, sheshet, rendet e fidanëve, gjelbërimi i lagjeve të komplekseve banesore dhe gjelbërime tjera).
- b) Pjesët mbrojtëse të lagjeve në vendet urbane, paralagjet, në vendet e banuara dhe vendet industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit, bregut të lumit dhe të sipërfaqeve të tjera ujore) përveç tokës mbrojtëse pyjore e cila është pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtjen nga erozioni.
- c) Sipërfaqet e gjelbëruara të ndërmarrjeve, të organizatave të ndryshme dhe subjekte tjera.
- d) Sipërfaqet e gjelbëruara me destinim të veçantë dhe të dobishme (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore historike, dhe objekteve tjera me rëndësi).
- e) Gjelbërimi i vendeve për rekreacion, i lokaliteteve turistike dhe shëtitore, sipas PZHK-së, PZHU-së dhe HZ-së.

Dispozitat e kësaj Rregullore nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokat bujqësore dhe pjesët tjera të natyrës për të cilat zbatohen dispozita tjera.

Neni: 21

Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e saponërtuara duhet të parashihen me projektet e ndërtimeve të tjera dhe të bëhet me anë të kontrollit profesional nga ana e Drejtorisë dhe shërbimeve përkatëse sipas sipas PZHK-së, PZHU-së dhe HZ-së.

Neni: 22

Projektet e objekteve të saponërtuara por edhe të atyre që ndërtohen në pjesët e ndryshme të qytetit duhet të kenë të përfshira edhe pjesën e gjelbëruar, në të kundërtën ato plane konsiderohen si jo të plota dhe nuk mundë të lejohen.

XI. Mbrojtja e tokës

Neni: 23

Personat juridikë dhe fizike të cilët me aktivitetet e tyre në territorin e Komunës, bëjnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, grumbullimin e mbeturinave, hirit, ngjyrës ose materialeve tjera, shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit, duhet të ruajnë shtresën sipërfaqësore të tokës, rivendosin regjimin e mëparshëm ujor dhe stabilitetin gjeo - mekanik të tokës gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve.

XII. Mbrojtja e ajrit

Neni 24

Subjektet të cilat disponojnë me burim të ndotjes së ajrit janë të obliguar që me masa tekniko-teknologjike dhe masat tjera, të sigurojnë që shkarkimet dhe shpërndarjet në ajër të jenë në kufijtë e vlerave të përkufizuara dhe përcaktuara me ligj dhe aktet tjera.

XIII. Mbrojtja e ujit

Neni 25

25.1. Në përputhje me aktet e veçanta normative të Qeverisë dhe me mundësitë e Komunës që të përballojë këto nivele, do të themelohen nivelet maksimale të lejueshme të shkarkimit dhe shpërndarjes së ndotësve të ujit.

25.2. Duke respektuar standardet dhe rregullat mbi vlerat e përkufizuara të ndotjes së ujit, ndalohet:

- a) shkarkimi në ujëra i materieve toksike dhe jotoksike, të ngurta, të lëngëta ose të gazta, organizmave të gjalla duke përfshirë edhe organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe formave të energjisë që shkaktojnë ndryshimin e kthjelltësisë, dekantimit, shtresimit dhe aromës ose ndryshime tjera në cilësinë e ujit;
- b) shkarkimi në sistemet publike të kanalizimit i ujërave të ndotura, të cilët përmbajnë substanca mbi vlerat e përkufizuara ose materiale të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë probleme në sistemin e kanalizimit ose objekteve për pastrimin e ujit;
- c) përdorimi i puseve të braktisura si gropa septike për ujëra të ndotura.

XIV. Mbrojtja nga zhurma

Neni: 26

26.1. Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, në përputhje me dispozitat e nxjerra nga MMPH, ndërmerr masa për mbrojtjen nga zhurma dhe me aktet e LPH, përkatësisht nga PZHK, PZHU dhe HZ, caktojnë zonat e vendbanimeve, zonat për pushim dhe rekreacion.

26.2. Komuna harton Hartën e Zhurmës.

26.3. Drejtoria e Inspeksionit bënë matjet sistematike të zhurmës dhe vibrimeve.

Ndalohet zhurma që kalon standardet e lejuara (90 dB) në hapësirat publike (nga muzika, nga veturat me zhurmë të lartë, nga lokalet që punohet me makina që kanë zhurmë të lartë që i pengojnë banorët për rreth dhe lloje tjera të zhurmës që i kalojnë standardet e lejuara (80 dB) nëpër vende rekreative të cilat janë të përcaktuara me PZHK, PZHU dhe HZ.

XV. Zonat e mbrojtura të natyrës

Neni: 27

27.1. Zonat me vlera të veçanta natyrore, me interes për Komunën, gëzojnë mbrojtje të veçantë me ligj dhe akte të tjera të nxjerra në pajtim me ligjin.

27.2. Me qëllim të ruajtjes së zonave të natyrës me vlera të veçanta, organet komunale kanë për obligim ti propozojnë dhe t'i shpallin, si dhe t'i menaxhojnë këto zona.

27.3. T'i propozojnë Kuvendit Komunal shpalljen e zonave të mbrojtura.

27.4. Për ruajtjen e tyre janë të obliguar të gjitha institucionet shtetërore e private si dhe të gjithë qytetarët e Podujevë.

27.5. Organet Komunale nxjerrin plane dhe dokumente tjera për menaxhimin e këtyre zonave.

XVI. Masat e veçanta për mbrojtjen e mjedisit

Neni: 28

28.1 Për rastet e aksidenteve të mundshme ekologjike ose rastet e rrezikimeve të jashtëzakonshme të mjedisit, rrezikimit të shëndetit dhe jetës së njerëzve në territorin e Komunës së Podujevës, Komuna me propozim të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe të Drejtorisë së Shëndetësisë nxjerrë planet e veprimit për këto raste :

28.2 Planet e veprimit duhet t'i përmbajnë këto pika :

- a) llojet e rrezikshmërisë si pasojë e aksidentit ekologjik,
- b) procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta të dëmshme për mjedis,
- c) organet për zbatimin e masave të caktuara,
- d) përgjegjësitë dhe autorizimet lidhur me zbatimin e masave.

XVII. Informimi për mbrojtjen e mjedisit

Neni: 29

Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit mban të dhëna, të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit, e të cilat përfshijnë pa kufizim:

- a) të gjitha subjektet që ndërmarrin veprimtari të autorizuara dhe veprimtaritë e tyre;
- b) kërkesat për miratim, licencat dhe autorizime të tjera që kërkohen të jepen dhe çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me to;
- c) çfarëdo informacioni tjetër të marrë ose të siguruar sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit apo akteve tjera normative;
- d) hollësi për gjoba të vendosura sipas Ligjit dhe akteve tjera normative.

XVIII. Mbikëqyrja

Neni: 30

30.1. Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bëjnë Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit; Drejtoria për Inspektion; Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim; Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe të gjitha organet që kanë ndikim të drejtpërdrejt në zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullore.

30.2. Në kuadër të kompetencave dhe detyrave, Zyrtari për Mjedis kryen këto detyra:

- a) Harton politikat mjedisore brenda territorit të Komunës dhe harton plane mjedisore për ruajtjen e natyrës dhe ambientit brenda territorit të Komunës dhe jep propozime për Kuvendin Komunal.
- c) Vendime, njoftime tjera komform nevojave që paraqiten duke u bazuar në Ligj,
- ç) Jep propozime për zgjedhjen e çështjeve të ndryshme mjedisore,
- d) Sjell standarde mjedisore në Komunë në harmoni me Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit dhe aktet e tjera të nxjerra nga ky Ligj,
- dh) Cakton prioritetet afatgjata dhe afatshkurtra mjedisore brenda territorit të Komunës.
- e) Punët administrative dhe profesionale i kryen në bashkëpunim me Ministrin për çështje të caktuara.
- ë) Mbikëqyr zonat e mbrojtura të natyrës.
- f) Bashkëpunon me organet më të larta komunale dhe ndërkomunale.
- g) Bashkëpunon me shoqërinë civile dhe komunitetin.

30.3. Në kuadër të kompetencave dhe detyrave inspektori i mjedisit kryen këto detyra:

a) Është përgjegjës për mbikëqyrjen e çrregullimeve mjedisore të karakterit lokal, ndikimi i të cilave nuk kalon kufijtë e Komunës dhe të cilat mund të zgjidhen, kontrollohen, parandalohen nga vetë Komuna.

b) Ndërmerr këto masa:

- i. Lëshon urdhëresa mbi mënjanimin e gjërave dhe sendeve të tjera nga sipërfaqet publike të cilat do të jenë në rrezik potencial për ndotjen e mjedisit, rrezikun e shëndetit dhe jetës së njerëzve.
- ii. Inspektori i Mjedisit nxjerr Aktvendim
- iii. Shqipton dhe arkëton gjobat e parashikuara me vendimet e Kuvendit Komunal dhe ndërmer merr masa tjera, për të cilat është i autorizuar me këtë Rregullore dhe dispozita të veçanta.
- iv. Në zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të tjera të veçanta Inspektori Komunal i Mjedisit shqipton masat administrative dhe merr veprime të tjera të cilat janë të autorizuara me vendimin e Kuvendit Komunal.

30.4 Kundër vendimit të Inspektorit Komunal për Mjedisin ankesa i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

XIX. Dispozitat ndëshkuese

Neni: 31

31.1 Të gjitha aktet normative të nxjerra në pajtim me Ligjin e Mjedisit do të përmbajnë dispozitat që specifikojnë gjobat që mund të imponohen për kundërvajtje.

31.2 Çdo dispozitë mbi gjobat e tilla të akteve plotësuese normative do të sigurojë që një gjobë e tillë është proporcionale deri në mënyrën e dënimit të shkaktuar dhe e interesit nga një kundërvajtje.

Neni: 32

32.1 Me gjobë në të holla prej **500-1000€** do të gjobiten të gjithë shkelësit e **nenit 5**.

32.2 Me gjobë në të holla prej **50-100 €** do të gjobiten të gjithë shkelësit e **nenit 6**;

32.3 Me gjobë në të holla prej **250-500€** për persona fizik, dhe **500-1000€** juridik do të gjobiten të gjithë shkelësit e **nenit 12 pika 12.3 nën-pika n) e pikës 12.3 dhe pika 12.2 e nenit 12**. Gjithë ashtu shkelësite **pikes 12.1 të nenit 12** dënohen me gjobë **200 – 300 €**.

32.4 Të gjitha personat juridikë që bien ndesh me **nenin 8** gjobiten me shumën prej **500-1000€**

32.5 Shkelësit e **nenit 9, pika 9.1 pika 9.2 pika 9.3** dhe **nenit 10** do të gjobiten me gjobën prej **200 – 300 €**.

32.6 Të gjithë autoritetet te cilët nuk i përmbahen **nenit 11** do të gjobiten me gjobën prej **500-1000 €**.

32.6 Shkelësit e **nenit 15 - pika 15.1 - nënpika a)** do të gjobiten me gjobën prej **250-500 €** për persona juridik, kurse për persona fizikë **100-150 €**. Shkelësit e **Nënpikës b) të pikës 15.1 e Nenit 15** dënohen me gjobë **250-500€** personat juridik dhe **100-150€** personat fizik. Kurse Shkelësit e **Nënpikës e) të pikës 15.1 e Nenit 15** dënohen me gjobë **100-150€** fizik dhe **250-500€** juridik. **Nënpika j) e pikës 12.3** **200-300€** fizik dhe **300-600€** juridik. **Nënpika l) e pikes 12.3 dhe nënpika a) e pikës 25.4:** **50-70€** për persona fizik dhe **50-100€** juridik. Shkelësit e **Nënpikës m) të pikës 12.3 dhe e pikes 12.4 nënpika b)** dënohen me gjobë **100-200€** për persona fizik dhe **250-500€** për persona juridik. **Nënpika k)** gjoba do të jetë **100- 200€** për persona fizikë dhe **250-500€** për persona juridik.

32.6 Shkelësit e **nenit 16 pikat 16.1 dhe nënpikat b),c,d) dhe e) e pikës 12.3 e nenit 12** do të gjobiten me gjobën prej **100-200€**, kurse shkelësit e **nënpikës a) të pikës 12.3 e nenit 12 gjobiten 150-200€** . Shkelësit e **nënpikës f) të pikës 12.3 gjobiten 100-200€** personat fizik, kurse personat juridik **500- 1000€**. Shkelësit e **nënpikës g) të pikës 12.3 gjobiten 50-100€** personat fizikë, kurse personat juridikë **200- 300€**. Shkelësit e **nënpikës h) të pikës 12.3 gjobiten 50-100€** personat fizik, kurse personat juridik **200- 300€**. Kurse shkelësit e **nënpikës i) të pikës 12.3 gjobiten 200-300€** personat fizik, kurse personat juridik **200- 300€**.

32.7 Shkelësit e **nenit 27** pikat **27.1** do të gjobiten me gjobën prej **600-1000€** për persona fizik **1500-3000€** juridik. **Pika 27.2** do të gjobiten me gjobën prej **300-800€** për persona fizik **1500-3000€** juridik. **Pika 27.3** do të gjobiten me gjobën prej **500-1500€** për persona fizik **1500-5000€** juridik.

32.8 Shkelësit e **nenit 15 pika 15.1 nënpika b)** do të gjobiten me gjobën prej **150-300€** për persona fizik dhe **500-1000€** juridik. Shkelësit të cilët nuk i përmbahen **Nenit 19** për pajisje me **Leje Mjedisore Komunale** gjobiten **500-800 €**.

32.9 Shkelësit e **nenit 26** do të gjobiten me gjobën prej **30-80€** për persona fizik dhe **200-400€** juridik.

32.10 Shkelësit e **nenit 11** gjobiten me gjobë prej **100 deri 200€** ekonomitë familjare, kurse me gjobë prej **200 deri 300€** objektet afariste.

Neni: 33

Inspektori Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit ka autorizim të shqiptojë dënimin (gjobën) mandator në shumë prej **5€ deri 100€**, në përputhshmëri me Udhëzimin Administrativ për Gjobat Mandatore.

Neni: 34

Nëse pengohet Inspektori Komunal në kryerjen e obligimeve të veta dhe nëse personi fizik apo juridik nuk jep informata për identitetin dhe informata tjera, gjoba do të jetë prej **100 deri 200€** për persona fizikë dhe **300 deri 500€** për persona juridikë.

Neni: 35

Për kundërvajtje të caktuar me këtë Rregullore nuk do të përfshihen jo madhorët (të miturit), por do të dënohen me gjobë prindërit respektivisht kujdestarët e tyre.

Neni: 36

Kundërvajtësit të cilët nuk i përgjigjen gjobave mandatorë, Inspektori i mjedisit do të bëjë kërkesë për ekzekutim te Përmbaruesi Privat.

XX. Dispozitat kalimtare

Neni: 37

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Drejtoria për Inspektion në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe në bashkëpunim me organe tjera komunale dhe ndërkomunale.

Neni: 38

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi 8 dit pas miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Podujevës.

Podujevë

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Në bazë të nenit 12, al.2, pika c, nenit 17, pika f, nenit 40 al.2, pika a dhe g, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 al.1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, dispozitat e neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L – 60, për Mbeturina, dhe nenit 41.2, shkronja c të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më xxx 2019, miratoi këtë:

Rregullore

Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, vlerën (shumën) e taksës për mbeturina, në funksion të krijimit të një sistem i qëndrueshëm financiar mbi menaxhimin e mbeturinave.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore definojnë kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave (zvogëlimin e sasisë së deponuar, ndarjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, dhe deponimin, aktivitetet e reciklimit) me qëllim të ruajtjes (mbrojtjes) së mjedisit jetësor nën juridiksionin e Komunës.

Neni 3

Përkufizimet

- 3.1 Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.
- 3.2 MM** – (më tutje i referohemi MM), aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
- 3.3 Operatori** – personi juridik i cili në përputhje me dispozitat e ligjit menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 3.4 Licenca për menaxhimin e mbeturinave** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjeve në fuqi.
- 3.5 Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 3.6 Konsumatori** – personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara
- 3.7 Ri-përdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë destinuar
- 3.8 Mbledhja** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 3.9 Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.
- 3.10 Prodhuesi i mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 3.11 Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
- 3.12 Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
- 3.13 Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme
- 3.14 Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale
- 3.15 Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
- 3.16 Mbeturina inerte** - që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të

ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3.17 I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës-mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

3.18 Mbeturinë e vëllimshme - mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

3.19 Qendrat grumbulluese – Lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

3.20 3R – reduktim, ripërdorim, reciklim

Neni 4

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

1. Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave e bënë personi juridik i licencuar dhe i kontraktuar nga komuna, i cili mbledhë grumbullon dhe transporton mbeturinat prej gjeneruesit e deri në deponinë e mbeturinave apo në vendet e licencuara për reciklim.
2. Mbeturinat e rrezikshme, paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mblidhen, grumbullohen dhe transportohen.
3. Nëse ndotja ndodh gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthej në gjendjen e më mëparshme.

Neni 5

Përgjegjësia e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave

- 5.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale
- 5.2 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- 5.3 Procesi i kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
- 5.4 Formimi i sektorit mbi menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtje të mjedisit.
- 5.5 Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
- 5.6 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të mbeturinave dhe evitimin e tyre.
- 5.7 Përcaktimi i lokacioneve, numrin dhe llojin e kontejnerëve në bashkëpunim me operatorin ose palët e treta
- 5.8 Promovimi i zvogëlimit të sasisë së mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)

- 5.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik, pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave
- 5.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave
- 5.11 Faturimi i taksës për mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
- 5.12 Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave:
a) faturimi
b) shkalla e inkasimit
c) sasinë e grumbulluar dhe të deponuar të mbeturinave
- 5.13 Shqyrtimi ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve për mbeturina
- 5.14 Përcaktimi i taksës dhe mënyra e arkëtimit të mjeteve financiare
- 5.15 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, për menaxhim të mbeturinave, më së largu 31 mars të vitit pasues.
- 5.16 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

- 6.1 Çdo gjenerues i mbeturinave është i obliguar të përfshihet në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe ka të drejtë qasjeje në shërbimin e ofruar,
- 6.2 Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.
- 6.3 Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit lokal të menaxhimit të mbeturinave.
- 6.4 Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme)
- 6.5 Çdo gjenerues i mbeturinave duhet që të paraqes ndryshimin e të dhënave (si p.sh. shitja e pronës, trashëgimia, dëshmitë dhe dokumentet tjera të përditësuara).
- 6.6 Regjistrimet e reja të amvisërive në databazë behën në bazë të këtyre kushteve;
- a. kontrata e shitblerjes
 - a.1 blerësi regjistrohet në databazë, nëse nuk është i regjistruar paraprakisht nga data e nënshkrimit të kontrates, derisa shitësit i ndryshohet vetëm adresa.
 - b. regjistrimi i njehsorit të rrymës elektrike
 - c. konfirmimi i pagesës së faturës për mbeturina në vendbanimin paraprak
 - d. dokumenti identifikues
- 6.7 Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.
- 6.8 Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.
- 6.9 Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të

konsumatorëve për mbledhje dhe bartjen e mbeturinave.

- 6.10 Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
- 6.11 Ndërmarrjet prodhuese, ndërtuese dhe tjera të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Podujevës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 7

Taksa mbi mbeturinat

- 7.1 Taksa për mbeturinat, faturohet dhe inkasohet nga Komuna.
- 7.2 Shpërndarja e faturës së mbeturinave bëhet bazuar në sistemin e të dhënave, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit deri më 31 Mars të vitit kalendarik.
- 7.3 Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguaj faturën e taksës së mbeturinave, për çdo muaj të vitit ose me këste si më poshtë:
1. Kësti i parë Janar – Mars
 2. Kësti i dytë Prill – Qershor
 3. Kësti i tretë Korrik- Shtator
 4. Kësti i katërt Tetor – Dhjetor.

Pagesa e taksës për mbeturinat, në shumën deri në 10 € mund të bëhet në arkën e komunës në Qendrën e Shërbimit me Qytetar, kurse në shumën mbi 10 € bëhet në institucionet financiare për pagesa.

- 7.4 Familjet që kanë shpenzime të energjisë elektrike deri në 3 tre muaj brenda vitit, fatura elektrike e cila është në shumën maksimale 15 €, ngarkohen me tarifë 13.50 €/vit, të dëshmuar me gjendjen për vitin përkatës.
- 7.5 Nëse pëson ndryshim çmimi i energjisë elektrike do të pësojë ndryshim edhe shuma maksimale (15€) sipas përqindjes së ndryshimit.
- 7.6 Dëshmi për kategorizimin e obligimit vjetor është pasqyra vjetore e harxhimit të energjisë elektrike, i cili sillet në fund të vitit kalendarik.
- 7.7 Çdo gjenerues që banon me qira është i obliguar të beje pagesën për mbeturina në emër të vet dhe duhet të regjistrohet në bazën e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar (qiradhënësi dhe qiramarrësi për banim).

7.8 Nëse Gjeneruesi i mbeturinave nuk e paguan këstin e fundit, nuk do të merr shërbime komunale administrative në:

1. Shërbime Kadastrale,
2. Shërbime nga DPUMM
3. Shërbimet nga DSHPMSH
4. Shërbimet nga zyra e Prokurimit.
5. Shërbimet nga DZHE
6. Shërbimet nga DBF,
7. Shërbimet nga DBPZHR, si dhe Drejtoritë tjera me përjashtim të sektorit të ofiqarisë.

7.10 Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:

- a. Konsumatorët e amvisërive:
 1. Rezident
 2. Jo Rezident
 - i. Të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët
 - ii. Të shërbyer me shërbimin derë më derë
- b. Konsumatorët komercial/industrial:
 - i. Dyqanet e vogla Zejtare dhe Shërbyese
 - ii. Subjekte të Mesme deri të Mëdha Komerciale me kosto të ulët të shërbimit
 - iii. Subjekte të Mesme deri të Mëdha Komerciale me kosto të lartë të shërbimit
- c. Institucionet:
 - i. Konsumatorët e vegjël institucional
 - ii. Konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucional
 - iii. Konsumatorët e mëdhenj institucional të shërbyer me kontratë

Detajizimi i mëtejshëm i kategorizimit dhe taksave gjendet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje

7.11 Shkalla e taksës do të rishikohet sipas nevojës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike duke marrë parasysh performancën e inkasimit.

7.12 Nëse Kuvendi komunal aprovon shkallën e përshtatshme të inkasimit të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal

7.13 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimi të mbeturinave që iu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar, për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Neni 8

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave

8.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

Neni 9

Veprimet e ndaluara

Me këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

1. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;
2. Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;
3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);
4. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
5. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
6. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike);
7. Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
8. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
9. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
10. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”
11. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
12. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
13. Dërdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në

- impianetet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
14. Personat duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
 15. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.
 16. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.
 17. Të gjitha ndërmarrjet hoteliere, mishtoret, blegtorët dhe personat fizikë obligohen që eshtrat e kafshëve të therura t'i vendosin në kontejnerë të caktuar. Ndërmarrja përkatëse e kontraktuar nga Komuna është e obliguar që këto mbeturina t'i dërgojnë në varreza përkatëse. Pronarët e fermave, personat fizikë janë të obliguar që kafshët e ngordhura t'i lajmrojnë, në kohët e nxehta (brenda 12 orëve pas kohës së ngordhjes së shtazës), në stinën e dimrit deri në (24 orë), për bartjen e tyre në vende të caktuar.
 18. Mbeturinat të cilat nuk i takojnë mbeturinave shtëpiake (mbeturinat e rrezikshme) mbahen deri në bartjen e tyre nëpër enë speciale në objektet, respektivisht në vendet e caktuara për to.
 19. Ndërmarrja është e obliguar, në qoftë se kërkohet largimi i mbeturinave të cilat konstatohen se nuk janë mbeturina shtëpiake, t'i marrë me kompensim të veçantë për hedhjen e tyre në vendin e dedikuar.
 20. Ndërmarrja e obliguar për punët e mirëmbajtjes duhet t'i pastrojë edhe hapësirat rreth kontejnerëve me rastin e zbrazjes dhe në çdo kohë të jenë në gjendje të pastër.
 21. Me qëllim të mirëmbajtjes më të mirë të gjendjes së pastërtisë në vendet publike vendosen shportat e mbeturinave, për të cilat kujdeset ndërmarrja përkatëse, nëse është e specifikuar me kontratë.
 22. Ndërmarrja përkatëse është e obliguar që në periudhën prej 3 muajve të dezinfektojë kontejnerët dhe hapësirat rreth tyre. Njëherit këtë mundë ta bëjë edhe në raste tjera me kërkesën e Inspektorit të Mjedisit.
 23. Ndërmarrja dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët dëshirojnë që në mënyrë të pavarur të bëjnë bartjen e mbeturinave të tjera në deponi, janë të obliguar që paraprakisht të marrin pëlqim me shkrim nga organet komunale kompetente si dhe t'i paguajnë ndërmarrjes përkatëse kompensim për hedhjen e mbeturinave në deponi sipas çmimit të përcaktuar nga organi kompetent. bartja e mbeturinave duhet të bëhet me automjete të mbyllura në mënyrë që të mos lejohet derdhja e tyre gjatë transportit deri në deponi.
 24. Kompania është e obliguar që t'i përmbahet orarit për grumbullim të mbeturinave në lagjet apo fshatrat e Komunës së Vitisë, po ashtu edhe qytetarët janë të obliguar që t'i përmbahen orarit të përcaktuar nga Kompania.
 25. Hedhja e mbeturinave dhe materialeve tjera fundrrinore në shtratin e lumenjve,

- përrenjve, kanaleve, në rrugë dhe sipërfaqeve të tjera publike;
26. Hedhja dhe vendosja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve si dhe në pronën e tyre, në vendet ku distanca nuk është e mjaftueshme nga vendet e banuara me popullatë njerëzore;
 27. Përdorimi i puseve të braktisura për t'i deponuar mbeturinat;
 28. Hedhja e vajrave motorike dhe derivateve të naftës në të gjitha vendet publike, përveç vendeve të caktuara nga organet kompetente;
 29. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në vendet publike, përveç vendeve të përcaktuara nga organet kompetente;
 30. Ndalohet bartja e mbeturinave dhe fekaleve me mjete që nuk janë të destinuara dhe të licencuara për bartje të tyre;
 31. Mbajtja e mbeturinave në kosha të cilat nuk i plotësojnë kushtet për mbajtjen e tyre;
 32. Ndezja e zjarreve prej mbeturinave dhe materialeve të tjera që ndotin ajrin dhe mjedisin në përgjithësi;
 33. Kompanitë janë të obliguara, që pas kryerjes së punimeve, t'i largojnë mbeturinat nga vend punishtja dhe deponimi i tyre të bëhet në deponi të licencuar.
 34. Hedhja e mbeturinave në kontejner të lagjeve tjera.
 35. Të gjitha amvisëritë/bizneset janë të obliguara që mbeturinat ti vendosin në kontejner adekuat dhe të i përmbahen orarit të grumbullimit.

Neni 10

Dispozitat Ndëshkuese

10.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përmbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të menaxhimit të mbeturinave do të inicohet procedurë sipas ligjeve në fuqi

10.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara, Neni 9, (par. 1-35) inspektori komunal, zyrtari policor, shqipton gjobë mandatorë sipas udhëzimit administrativ 14/2015, apo gjobat tjera të përcaktuara sipas Ligjit për mbeturina (Nenet 70-75).

Neni 11

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në fuqi

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.
2. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtorja e Inspeksionit, dhe zyrtarët e tjerë të autorizuar nga ana e Komunës.
3. Me këtë rregullore të njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Financave.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe do të zbatohet nga dita, muaji, viti 2019.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e Rregullores nr. 01-006-16407 të datës 4 Shkurt 2015 për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Podujevës.

Podujevë

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi